Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit dhe kanatit të jenë borduara me material plastik PVC me trashësi 0.8 mm. Kanati të ketë mbyllje me çelës. Kanatet do të montohen me mentesha me thithje . Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarje që formojnë dy hapësira në pjesën e poshtme. Xok ola do të jetë 8 cm e lartë me po të njëjtin material si skeleti. Të jetë i pajisur me tapa plastike kundër gërvishtjes. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi. Aksesori është përdorur të jenë cilësorë . Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

21. Shtrat vizite Infermierie

Përmasat: 180 x 60 x 75- 80 cm

Shtrati i vizitës do të ketë dimensione të përafërta 180cm x 60cm. Lartësia 75-80 cm. Sipërfaqja të jetë e përbërë nga një segment fiks dhe një segment me kënd të rregullueshëm. Pesha mbajtëse jo më pak se 100 kg. Skeleti do të ndërtohet me profil metalik tubolar me seksion katror 40 x 40 mm me spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm. Elementët lidhës do të jenë profil tubolar me seksion 40 x 20 mm me spesor jo më të vogël se 1.5 mm. Si mbështetje do të kemi pllakë zdrukthi me trashësi 18 mm të veshur me sfungjer të cilësisë së lartë, e veshur me tekstil. Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1725:2023.

22. Garderobë 3 kanate

Përmasat: 120 x 55 x 200

Materiali i skeletit dhe kanatet do të jetë me pllake zdrukthi të melaminuar, me trashësi 1.8 cm. Bordet anësore të skeletit, sergjeneve dhe kanateve do të jenë të veshura me PVC me trashësi 0.8 mm, me ngjyrën e materialit. Kanatet do të montohen me mentesha metalike me thithje që lejojnë hapjen e lirë të kanateve. Materiali të ketë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokola do të jetë 8 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Kanatet të mbyllën me çelës. Pjesa me dy kanate të ketë një ndarëse në pjesën e sipërme një varëse rrobash tub, një ndarëse në pjesën e poshtme. Pjesa e brendshme e kanatit tek të ndahet në minimum 5 (pesë) hapësira nëpërmjet 4 ndarësive me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanateve dhe aksesori të përdorur të jenë cilësorë. Shpina e mobiljes të jetë fibër 4 mm trashësi.

Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

23. Stola për dhomat e ndërrimit

Përmasat: Min 100x40x45cm Max 110x50x55 cm

Stolat e dhomave të ndërrimit me listela druri me seksion 2,5 x 5cm dhe strukturë hekuri. Stol i përbërë nga strukturë prej profili hekuri me seksion 40 x 20mm, raft i poshtëm për pushimin e këpucëve po me listela druri me seksion 1,5 x 5cm.

24. Tabele drhuri për të varur shenimet

Përmasat: Min 180x7.5 D x120 "H cm Max 190x8.5 D x130 "H cm

Thellësia e brendshme 2.5 cm e këtij dollapi 180 x 120 cm do të thotë se është e lehtë të montosh njoftime. Veshjet elegante prej alumini sigurojnë një mënyrë tërheqëse dhe të qëndrueshme për të kornizuar informacionin dhe njoftimet tuaja të rëndësishme. Dera me mbyllje me çelës përmban panel akrilik transparent rezistent dhe siguri. Rubber-Tak është një sipërfaqe me strukturë unike e prodhuar nga gomë të ricikluar për të siguruar qëndrueshmëri të pakrahasueshme. Vrimat e kunjve praktikisht zhduken në sipërfaqen e vetë-shërimit, e cila është gjithashtu rezistente ndaj njollave. Goma është rezistente ndaj lagështirës, rezistente ndaj kimikateve dhe nuk do të mbështesë rritjen e mykut ose baktereve. Paneli akrilik i qartë rezistent ndaj copëtimit. Zgjidhni midis mbështjellësve prej gomë-tak, tapë natyrale ose vinili.

Të plotësojë kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015

25. Karrige për nxënës cikli i lartë (CL)

Përmasat:

Lartesi: 70/42 cm

Gjeresi: 37 cm

Thellesi: 37 cm

- **Ndenjësja dhe mbështetësja:** Të punohen me material HDF dhe pjeserisht kompesate me trashësi jo me te vogël se 7 mm në formë anatomike, (të kurbuar) ose plastike të fiksuar ose material frezilit, i derdhur në të gjithë trupin e ndejtjes dhe të shpines kapur fort në skeletin metalik me preçina/vida druri. Sipërfaqja e ndenjësjes dhe mbështetësjes të jete me qoshe dhe buzë të rrumbullakuara Produkti parashikohet prodhim, furnizim dhe instalim në shkollë.
 - Skeleti duhet të jete me profil tubolar oval ku në të dyja anet e tubit të jete i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15 mm dhe spesor jo me te vogël se 1.2 - 1.5mm.
- I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldime të vazhduar me argon dhe i lyster me bojë elektrostatiqe, në pjesët fundore të këtyre tapave plastike.

Toleranca në dimensione do të jete +/-

26. Tavolina për nxënës cikli i lartë (CL)

Përmasat: 120 x 75 x 45cm

Suprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i suprinës me skeletin duhet të bëhet me Vida të fshehta ose me preçina me kokë Ø4. Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me permasa 110 x 26 cm MDF e melaminuar 16 mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve. Montimi i syprinës me skeletin të bëhet me vida të fshehta. Në pjesën ballore të vendoset një element me permasa 110 x 14.5 cm, me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht. Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku në të dyja anët e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të tavolinës, me seksion jo më të vogël 50 x 25 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubularoval ku në të dyja anët të rrumbullakosur jo më të vogël se 50 x 25mm, me spesor jo më të

vogël se 1.2 mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20 x 20 mm, spesor jo më të vogël se 1.2 mm, e lyer me bojë elektrostатike ngjyrë sipas kërkesës së klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023

27. Tavolina për nxënës cikli i ulët (CU)

Permasat: 120 x 64 x 45 cm

Suprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet të ketë trashësinë më të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i suprinës me skeletin duhet të bëhet me Vida të fshehta ose me preçina me kokë Ø4. Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura një element me permasa 110 x 26 cm MDF e melaminuar 16 mm dhe e frezuar perimetralisht, që shërben për mbajtje të librave të nxënësve. Montimi i suprinës me skeletin t 137 bëhet me vida të fshehta. Në pjesën ballore të vendoset një element me permasa 110 x 14.5 cm me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht. Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku në të dyja anet e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të tavolinës, me seksion jo më të vogël se 50 x 25 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubolar oval ku në të dyja anët të rrumbullakosur jo më të vogël se 50x25mm, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20 x 20 mm, spesor jo më të vogël se 1.2 mm, e lyer me bojë elektrostатike ngjyrë sipas kërkesës së klientit. Në fundet e tyre të kenë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023

28. Karrige për nxënës cikli i ulët (CU)

Permasat: 35 x 38 x 37/70 cm

Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material werzalit, i derdhur në të gjithë trupin e ndenjësës dhe të shpinës. Materiali i derdhur i werzalit duhet të jetë i qendrueshëm kundër lagështirës dhe gërvishtjeve. Ndenjësia dhe shpina të jenë të harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe në formë anatomike). Skeleti duhet të jetë me profil tubolar oval ku në të dyja anët e tubit të jetë i rrumbullakosur, që të japi fortësinë dhe imazhin e dukshëm të karriges, me seksion jo më të vogël 30 x15 mm dhe spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5 mm. I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon dhe i lyer me fushë elektrostатike, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.

Të plotësojë kërkesat e standartit SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar

29. Tavolinë kopshti drejtkëndore (parashkollori)

Përmasat (120 x 80 x 55 cm)

Materiali i skeletit të jetë me konstrukcion druri, ahu i staxhionuar, e përpunuar dhe e latuar në të gjitha cepat e saj. Syprina e saj MDF e laminuar me trashësi 18mm dhe bordet perimetrale të rrumbullakosur. I gjithë montimi bëhet me elementë të fshehur dhe jo të dukshëm

30. Varse rrobash + mbajtese cadrash (e levizshme)

Struktura duhet të ketë një bazament rrethor me diametër jo më të vogël se 40 cm, i rëndë dhe solid. Të ketë 6 vende për të varur rroba dhe një vend bashkangjitur për çadra.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku **vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë **jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

2.2.2 Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024, të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2024 dhe kestin perkates per vitin 2025. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB). *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombetare dhe të paraqesë:

Standartin ISO 9001:2015 (ose e përditësuar), për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Standartin ISO 45001: 2018 / ISO 45001-2023 (e përditësuar), Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Standartin ISO 14001:2015 ose ekuivalente ose Leje Mjedisore, „Per Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit“ (e vlefshme); objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur është i profilit prodhues i produkteve të mobilerise duhet të ketë të punësuar minimalisht 30 (tridhjet) punonjës, kur është i profilit tregëtues i produkteve të mobilerise (kur është tregëtues i mbi 50 % të zerave të artikujve të kerkuar të mobilerise) jo më pak se 20 punonjës të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën 1 (një) muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr. 9 (Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 26, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik sipas natyres se tij prodhues apo tregëtues (operator ekonomik tregëtues kur është tregëtues i mbi 50 % të zerave të artikujve të kerkuar të mobilerise) duhet të ketë minimalisht të punësuar punonjës sipas profesioneve sipas listës së profesioneve, konkretisht:

1 (një) inxhinier druri (operatorët ekonomik të profilit prodhues) vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

1 (një) arkitekt (operatorët ekonomik të profilit prodhues dhe tregëtues sipas klasifikimit të mesipërm) vërtetuar me:

- kontratën individuale të punës;

-diplomën, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm

4 (kater) marangoz/ mobilier/ montues mobiljesh/ përpunues druri vërtetuar me (operatorët ekonomik te profilit prodhues dhe tregetues sipas klasifikimit te mesiperm):

-kontratën individuale të punës;

- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

2 (dy) saldator (operatorët ekonomik te profilit prodhues) vërtetuar me:

kontratën individuale të punës;

- diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit ne profesionin respektiv, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

2 (dy) shofer (operatorët ekonomik te profilit prodhues dhe tregetues sipas klasifikimit te mesiperm) vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës ose me kontraktim.

-leje drejtimi, e vlefshme;

4 (kater) punonjës të thjeshtë (operatorët ekonomik te profilit prodhues dhe tregetues sipas klasifikimit te mesiperm) për veprimtari ndihmëse gjatë procesve të punës vërtetuar me:

-kontratën individuale të punës;

Shenim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) punonjes te disponoje çertifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune" ne perputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dorezoje:

Kontratë pune e vlefshme

Certifikaten perkatese.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për transportin e mallrave objekt prokurimit duhet të disponojë, mjetet e mëposhtme:

Mjete	Sasia	Gjendja
Mjet transporti me kapacitet mbajtes min 1.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues pavaresisht profilit të tij duhet të deklarojë se zoteron në pronësi ose me qira ambiente të pershtatshme prodhimi/montim/magazinimi.

a) Për ambientet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e objektit sipas legjislacionit

b) Për ambientet me qera/huapërdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton marrjen me qera dhe regjistrimin e objektit në pronësi të qiradhenesit.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jete nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues pavaresisht profilit të tij duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt e listës si më poshtë:

- Karrige nxënësi cikël i ulët/lartë
- Karrige statike pa krahë mbështetës
- Tavolinë mësuesi cikël i lartë, arsimit të mesëm
- Dollap me dy kanata
- Raft për dosje, (etazher)
- Tavolinë nxënësi cikël i ulët/lartë
- Tavolinë për sallë polifunksionale
- Tavolinë kompjuteri
- Raft për Bibliotekën
- Tavolinë për kabinet treshe
- Dollap gardërobë për fëmijë
- Tavolinë kopshti drejtkëndës

Këto dokumente (katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike) duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me

qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

2.3.9. Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve që marrin persiper për furnizim, për artikujt e kërkuar si me poshtë krahas deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike, duke qenë se kontrolli i jashtëm dhe sipërfaqësor nuk evidenton tregues të padukshëm, specifik, të matshëm dhe vlerësueshëm nga institucione të specializuara duhet të paraqesë, dokumentacion të leshuar nga institucione të akredituar për leshimin e certifikatave ose për kryerjen e testeve dhe analizave si, “*Certifikate (korespondues i produktit të kërkuar)/Certifikate Testimi (korespondues i produktit të kërkuar)/Raport testimi (korespondues i produktit të kërkuar)*” për të vertetuar shkresërisht që produktet që ofrojnë në këtë procedurë, plotësojnë kërkesat e standardeve respektive si me poshtë:

- Karrige statike pa krahe mbështetës (Karrige), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020+A1:2022 “Mobilje zyre - Karrige pune për zyrë - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve, ose e njëvlefshme dhe e perditesuar”, SSH EN 1335-2:2018 “Mobilje për zyrë - Karrige për zyrë - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë” ose e njëvlefshme dhe e perditesuar

- Tavoline pune (tavoline pune/zyre), produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 527-1:2011 “Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat”, ose e njëvlefshme dhe e perditesuar SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 “Mobilje për zyrë - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe qëndrueshmërisë” ose e njëvlefshme dhe e perditesuar

- Karrige nxënësi cikël i ulët/ose lartë/ose mesëm produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2023 (Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e perditesuar

- Tavolinë nxënësi cikël i ulët/ ose lartë/ose mesëm produkt i certifikuar në përputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015 (SSH EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e perditesuar

- Tavolinë kopshti drejtkëndëshe SSH EN 1729-1:2015: (SSH EN 1729-1:2015/AC:2016), Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2023 Mobilje - Karrige dhe tavolina për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës ose e njëvlefshme dhe e perditesuar

Si dokument alternativ ne vend te “Certifikate (korespondues i produktit te kerkuar)/Certifikate Testimi (korespondues i produktit te kerkuar)/Raport testimi (korespondues i produktit te kerkuar)” te produkteve koresponduese me standardet e mesiperme, operatori ekonomik (bashkimi i operatoreve ekonomik sipas pergjegjesise) mund te paraqese Certifikata me reference standarde ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate qe nuk i referohet sistemit europian EN te standardeve, por nje sistemi tjetër standardesh por qe trajton te njejtet tregues dhe norma te testuara dhe konfirmuara te produktit si ne sistemin EN)/te “Perditesuara” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara per leshimin e ketyre dokumentave ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. Autoriteti Kontraktor pranon si dokumenta alternativ dhe dokumenta te tjere “Certifikate Konformiteti/Deklarate Konformiteti”, “Deklarate CE” “Skeda Teknike”, “Pasaporta Teknologjike” me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me “Certifikatat e testimit/Raportet e Testimit” leshuar nga institucione te akredituara per kryerjen e testeve dhe analizave te ketyre produkteve.

Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme ne periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues/perpunues i artikujve te mobilerise (vetem i artikujve te mobilerise) ose sipas tabelës 2 nese eshte tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhues per artikujt e mobilerise (vetem i artikujve te mobilerise) objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar** nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			

Etj.,			
-------	--	--	--

Per mallrat objekt prokurimi qe perfshihen ne tabelen 2, OE duhet te paraqese "Autorizim Prodhuiesi/Autorizim Distributori/Kontrate furnizimi ose cdo dokument tjetër qe konfirmon lidhjen me furnizuesin apo posedimin e tyre". Dokumentet duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi.

Per artikujt per te cilet eshte kerkuar dokumentacion teknik "*Certifikate (korespondues i produktit te kerkuar)/Certifikate Testimi (korespondues i produktit te kerkuar)/Raport testimi (korespondues i produktit te kerkuar)*", dokumentacioni duhet te jete ne emer te kompanise shitesse te mallit per operatorin ofertues te profilit tregetues te produkteve te mobilerise te deklaruar ne tabelen 2.

2.3.10. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 1 (nje) vjecare të garancisë së mallrave objekt prokurimi (te gjithë mallrave te prokuruar) ose nese garancia per artikuj te vecante eshte kerkuar ne dokumentin e specifikimeve teknike, garancia e tyre duhet te jete minimalisht sa eshte ky percaktim. Garancia fillon nga data e dorëzimit të mallit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

2.3.12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se, "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin."

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis

Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----

Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

